

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 318 rep.
Nr. 978 kol.



KONTRATE SHITBLERJEJE

Sot me date 25.10.2003, ditën e shtunë, në Dhomen e Noterisë Tirane, përpara meje noteres Eriketa Kokoli, me seli në rrugën "E Durrësit" u paraqitën palet:

SHITESI:

PAOLO MELLANO, i biri i Micheles dhe Maries, lindur me 15.07.63 në Fossano, i përfaqësuar me prokuror të posaçmë, me datë 21.10.2003 nga zoti Ret Pilika, i biri i Rikos dhe Elianes, lindur me 12.06.1977 në Tiranë, banues në rrugë Reshit Petrela, pallati përballë Stacionit të Trenit, Tiranë, me pasaportë nr.863361, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

BLERESI:

BI ESSE S.p.A, me seli në Genola – CN, via Marconi 64, Itali, person juridik i regjistruar pranë Gjykatës së Saluzzos në Regjistrin e Ndermarrjeve me nr. CN203 - 4575, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive nr. 135919, me partitë IVA 01786630044, e përfaqësuar me vendim të Këshillit Administrativ të datës 21.10.2003, përmbledhja e të cilit është noterizuar nga noteri Massimo Martinelli nga Fossano – Itali me vertetimin N.154562 rep. të datës 21.10.2003, nga administratori i deleguar zoti Luigi Trigari, i biri i Alessandros dhe Pasqualines, lindur me 28.05.1955 në Fossano, banues në via San Michele N. 21, Fossano – Itali, me pasaportë Y300070, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

SHITESI Paolo Mellano është ortak me 15 kuota të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 1.200.000 leke, në shoqërinë A Bi Esse sh.p.k, të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, me numer vendimi 11918, me datë 24.08.1995, që ka ndryshuar pjesëmarrjen në kapitalin themeltar me vendimin nr. 11918/5 të datës 11.06.2001 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Sipas vendimit të asamblesë së ortakëve të datës 25.10.2003, Paolo Mellano i shet shoqërisë Bi Esse S.p.A. 15 kuotat (me vlerë nominale 80.000 leke për çdo kuota) që ai zotëron në kapitalin e shoqërisë A Bi Esse sh.p.k. me vlerën totale 1.200.000 leke, vlerë e cila është shlyer nga blerësi, dhe largohet vetë nga shoqëria.

BLERESI: shoqëria Bi Esse S.p.A. është dakord të blejë të 15 kuotat e Paolo Mellanos (me vlerë nominale 80.000 leke për çdo kuota) me vlerën totale 1.200.000 leke, vlerë e cila i është shlyer shitesit, dhe rrit kështu pjesëmarrjen e vet në kapitalin e shoqërisë A Bi Esse sh.p.k. në 50 kuota me vlerën 4.000.000 leke.

Mbas nënshkrimit të kësaj kontrate palet deklarojnë që nuk kanë me asnjë pretendim ndaj njëri tjetrit.

Kjo kontrate shitjeje behet me vullnetin e lire te paleve, te cileve, pasi iu lexua me ze te larte ne prezence te perkthyeses Eliana Pilika, te njohur personalisht prej meje, dhe u kuptua, u nenshkrua rregullisht prej tyre dhe une noterja vertetoj sipas ligjit.

Tirane, me 25 tetor 2003.

SHITESI

Paolo MELLANO


i perfaqesuar me prokure te posacme nga

Ret Pilika

RET PILIKA



Perkthyesse
Eliana Pilika




BLERESI

Per Bi Esse S.p.A.

Administratori

Luigi Trigari



NOTERE

Eriketa KOKOLI

